



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr 12-353-22880 dt. 29.06 2020

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me date **29.06.2020**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelen 2048/0 e cila është në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe parcelen 235/0 e cila është në zonën kadastrale në Zabel të Epërme.

Neni 1.

I lejohej Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërtimi i dy fushave sportive, në lokacionet e propozuara, të cilat janë pronë e Komunës së Drenasit, si:

-Propozimi i parë është në zonën kadastrale në Zabel të Epërme, në pjesën e ngastrës kad. Nr.235-0, me S-30664 m², me kulturë- kullosë, klasa 3, sipërfaqja e kërkuar S=2500 m².

-Propozimi i dytë është në zonën kadastrale në Abri e Epërme, në pjesën e ngastrës kad. Nr.2048-0 ,70102 m², me kulturë- kullosë, klasa 4, sipërfaqja e kërkuar S=2500 m².

Neni 2.

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që në bashkpunim me Drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Drenasit të siguroi dokumentacionin valid si lejën e ndërtimit dhe kushtet tekniko-urbanistike për lokacionin e destinuar për ndërtim të këtyre dy fushave sportive.

Neni 3

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin në RDPP.

Neni 4

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës , dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Drenasit.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: -Kopja e planit dhe Çertifikata e njësisë kadastrale.

Neni 5

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse
- Zyrës së Kuvendit
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Lahmir Halilaj